



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 34, Datë 26.12.2014

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|------------------------|----------|
| - Znj. Klotilda Neziri | Kryetare |
| - Z. Zamir Stefani | Anëtar |
| - Znj. Ermonela Xhafa | Anëtare |
| - Z. Sokol Pasho | Anëtar |

në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, vijoi shqyrtimin e ankesave kundrejt Zyrës së Këmbimit Valutor “Pro-Exchange”, për aplikim komisioni për çdo transaksion këmbimi valutor.

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve në shqyrtimin e kësaj ankese

VËREN SE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve ka filluar shqyrtimin e kësaj çështjeje në bazë të shkresës me nr. 1222, datë 03.05.2013, të Bankës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 26.11.2012 ku dhe vendosi të kërkojë informacion sqarues nga ZVK Pro-Exchange dhe nga Banka e Shqipërisë, me shkresë nr. prot 18 datë 03.02.2014.

Komisioni, në mbledhjen e datës 26.12.2014, mori në shqyrtim informacionit e dërguar me shkresë nr. prot 8578, datë 15.12.2014, nga ZVK Pro-Exchange ku, me anë të së cilës, kjo zyrë, sqaron se aplikon një komision 8% për çdo transaksion këmbimi valutor në përputhje me Rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për Licencimin, Organizimin, Veprimtarinë dhe Mbikëqyrjen e Zyrave të Këmbimit Valutor”

Në këtë mbledhje u zhvillua dhe seanca dëgjimore me përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë, si institucioni licencues, rregullues dhe mbikëqyrës edhe për Zyrat e Këmbimit Valutor.

Për një vlerësim më të plotë të çështjes, Sekretariati Teknik i KMK, i ngarkuar nga Komisioni, ka konstatuar se Z.V.K. “Pro Exchange” sh.p.k, për çdo transaksion të këmbimi valutor, aplikon dhe një komision në masën 8%, mbi kursin e këmbimit të publikuar. Në lidhje me aplikimin e këtij komisioni, informacioni për konsumatorët, është i publikuar në brendësi të ambientit, me germa të vogla dhe jo në gjuhën shqipe.

Gjithashtu, konsumatori nuk vihej në dijeni përpara kryerjes së transaksionit për aplikimin e komisionit, mbi kursin e këmbimit të publikuar, por pasi i janë kërkuar të dhënat personale dhe pasi i është prerë fatura për këtë shërbim.

Kjo praktikë tregtare bie në kundërshtim:

Së pari, me nenet 13 dhe 15 të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” të ndryshuar, duke përbërë kështu një praktikë të padrejtë tregtare, nëpërmjet dhënies së një informacioni të mangët dhe çorientues, duke e bërë konsumatorin mesatar të marrë një vendim, që në të kundërt mund të mos e kishte marrë.

Së dyti, me nenin 16 të Rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për Licencimin, Organizimin, Veprimtarinë dhe Mbikëqyrjen e Zyrave të Këmbimit Valutor”

PËR KËTO ARSYE :

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve, mbështetur në nenin 7, 9, 12, 13, 15, 17, 52 dhe 52/1, të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si dhe në pikën 3 shkronja a, pikën 6 shkronja a dhe b, pikën 31 dhe 32 të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të komisionit të mbrojtjes së konsumatorit, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”

VENDOSI:

1. Z.V.K. “Pro Exchange” sh.p.k të marri masat për zbatimin e kushteve sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar,
2. Z.V.K. “Pro Exchange” sh.p.k të marri masat për publikimin e çmimit të plotë të transaksionit valutor. Në rast të aplikimit të komisionit për çdo transaksion, të marrë masat për njoftimin në një vend të dukshëm dhe në gjuhën shqipe.
3. Z.V.K. “Pro Exchange” sh.p.k të njoftojnë Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve për zbatimin e këtij vendimi, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit.
4. Publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të MZHETS.

KRYETAR I KOMISIONIT

KLOTILDA NEZIRI